




Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborna komisija za žalbe i molbe



A nr. 63/2010

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, në panelin e përbërë nga Muharrem Shala, kryesues, Ymer Hoxha dhe Fahredin Ymeri, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat e parashtruara për parregullsitë në procesin e votimit për raundin e dytë për zgjedhjen e kryetarit të Komunës së Gjilanit, nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Grupi Ndërkombëtar i Krizave (GNK), në seancën e mbajtur më 04.02.2010, mori;

V E N D I M

I. Pranohen të bazuara ankesat : A. nr. 401; 421; 447; 448; dhe 483.

II. Udhëzohet Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) të urdhëroj përsëritjen e votimit në komunën e Gjilanit.

A r s y e t i m

Pas ditës së zgjedhjeve për Kryetarë të Komunës së Gjilanit të mbajtura me dt.13 Nëntor 2009, për raundin e II-të të zgjedhjeve, KZAP-i ka pranuar disa ankesa lidhur me mashtrimet, pa rregullsitë dhe gabimet tjera gjatë procesit zgjedhor me rastin e votimit dhe numërimit në qendra të votimit dhe vendvotime të ndryshme në komunën e Gjilanit.

Parashtruesit e ankesave në ankesat e tyre kanë cekur se në shumë vendvotime ka pasur vjedhje votash, blerje të komisionerëve, falsifikime të nënshkrimeve dhe procesverbaleve dhe mbushje të kutive të votimit në mënyrë të pa rregullt, presione dhe shantazhe etj. Kështu, LDK, sipas ankesës A nr. 483, pretendon për parregullsi të ndryshme në 16 qendra të votimi; sipas ankesës A. nr. 421, pretendon parregullsi të ndryshme në 2 qendra votimi; sipas ankesës A. nr. 401 pretendon për parregullsi në një qendër votimi ndërsa sipas ankesës A. nr. 447 pretendon për parregullsi në një qendër votimi, ndërsa Grupi Ndërkombëtar i Krizave ka paraqitur ankesën A. nr. 448, me të cilën pretendon për parregullsi në një qendër votimi, duke propozuar që KZAP-i t'i anuloj rezultatet e votimeve në këto qendra votimi.

KZAP-i, gjithsejtë ka pranuar ankesa për Komunën e Gjilanit lidhur me parregullsitë serioze dhe mashtrimet për 21 (njëzetënjë) qendra të votimit.

Paneli i KZAP-it në bazë të nenit 6.3 të Rregullave dhe Procedurave të KZAP-it ka vendosur të bashkon të gjitha ankesat e parashtruara dhe ti trajtoj si një ankesë

për shkak të natyrës së ngjashme të rasteve dhe për të gjitha të vendos me një vendim për shkak të efikasiteti dhe ekonomizimit të procedurës.

KZAP-i në bazë të nenit 117.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP (Ligji nr – 03/L-073) i ka shqyrtuar pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre dhe të provave tjera që gjinden në shkresa të lëndës, ka konsideruar se është e pa nevojshme caktimi i seancës dëgjimore dhe ka gjetur se:

Ankesat janë të bazuara

Nga provat në shkresa të lëndës dhe nga rezultati i hetimit i kryer nga hetuesit e KZAP-it, e duke vepruar edhe sipas vërejtjeve të theksuara në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë, A.nr. 987/2009 të datës 27. janar 2010, e të cilin është anuluar vendimi KZAP-it nr. 508, i dt. 19.12.2009, për komunën e Gjilanit, Paneli i KZAP-it, në seancën e dt. 04.02.2010, pas analizimit dhe vlerësimit të gjithanshëm të provave vërtetoj këtë gjendje faktike :

Në bazë të raportit të hetuesve të angazhuar nga KZAP-i, të cilët kanë përcjellur dhe hetuar parregullsitë e theksuara në ankesat e cekura më lartë, nga shikimi dhe vlerësimi i Listës Përfundimtare të Votuesve (LPV) dhe Librave të vendvotimeve, konstatimi i fakteve të mashtrimit, hetimet në analizën e nënshkrimeve në LPV dhe Formularin e Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve si dhe nga kontrolli i FPR-ve dhe nga fotokopjimet e materialeve relevante, lidhur me parregullsitë e pretenduara janë konstatuar të dhëna dhe parregullsi që kishin dallim të dukshëm nga normat statistikore (mostrat e dyshimta të votimit, mospërputhja e papranueshme në mes të numrit të fletëvotimeve të numëruara në kuti dhe numrit të nënshkrimeve në Formularët e Përputhjes së Rezultateve etj.).

Në kuptim të nenit 91 LZP është paraparë se procedura për votim të rregullt vendoset përmes rregullave të KQZ-së, dhe në bazë të njëjtin nen votimi në zgjedhje të njëjta me shumë se njëherë është vepër penale. Në bazë të rregullave zgjedhore të KQZ-së 9/2009 - neni 11.4 është paraparë se nëse emri dhe mbiemri i votuesit gjendet në LPV pa një shenjë ose shënim, votuesi duhet të udhëzohet të nënshkruhet në LPV pranë emrit të tij apo të sajë. Gjatë hetimit është konstatuar shkelja e kësaj rregulle zgjedhore duke përfshirë disa kategori të nënshkrimeve të parregullta si: shumëfishimi i nënshkrimeve të cilat kanë të njëjtin dorëshkrim, nënshkrime të bazuara vetëm në emër dhe mbiemër të votuesit të shqiptuara në mënyrë të gabuar, përdorimi shumë shpesh vetëm i inicialeve apo shkronjave të mëdha në vend të nënshkrimit.

Paneli vlerësoj se në bazë të raportit të KQZ për Gjilan rrjedhë se Kandidati i LDK-së për Gjilan ka pasur 16889 vota, ndërsa Kandidati i PDK-së 17854 ashtu që numri i fletëvotimeve të rregullta nuk përputhet me votat e kandidatëve për 397 vota.

Në disa qendra të votimit është konstatuar se ka pasur shkelje të nenit 15.4.e të Rregullës Zgjedhore 9/2009 që ka ë bëjë më procesin e numrit në vendvotime të rregullta, sipas së cilës, në prani të kryesuesit të ekipit të numërimit, anëtarët e ekipit të votimit duhet të nënshkruajnë FPR-të para dorëzimit të të gjithë formularëve, materialin dhe kutitë e mbyllura të votimit tek ekipi i numërimit, ashtu që pastaj ekipi i votimit do të lëshojë VV, pas dorëzimit. Nga hetimi është konstatuar se në disa raste anëtarët dhe kryesuesi i KVV-ve nuk kanë nënshkruar FPR-të e në disa janë konstatuar nënshkrime të parregullta, siç shihet më poshtë.

Paneli në bazë të dhënave nga hetimet e kryera ka konstatuar shkeljet si vijon:

1. QV 0401D/14R – Lista Përfundimtare e Votuesve përmban 22 nënshkrime që tregojnë dëshmi rreth mashtrimit.

Lista Përfundimtare e Votimit,

faqja 1/ 1 nënshkrim mashtrues;
faqja 5/ 1 nënshkrim mashtrues;
faqja 6/ 1 nënshkrim mashtrues;
faqja 7/ 1 nënshkrim mashtrues;
faqja 9/ 1 nënshkrim mashtrues;
faqja 11/1 nënshkrim mashtrues;
faqja 13/1 nënshkrim mashtrues;
faqja 21/ 1 nënshkrim mashtrues;
faqja 24/ 1 nënshkrim mashtrues;
faqja 25/ 1 nënshkrim mashtrues;
faqja 26/ 1 nënshkrim mashtrues;
faqja 27/ 1 nënshkrim mashtrues;
faqja 28/ 1 nënshkrim mashtrues;
faqja 33/ 1 nënshkrim mashtrues;
faqja 34/ 2 nënshkrime mashtrues;
faqja 35/ 3 nënshkrime mashtruese;
faqja 36/ 1 nënshkrim mashtrues;
faqja 37/ 1 nënshkrim mashtrues.

Këto parregullsi të nënshkrimeve paraqesin shkelje të Nenit 91.2 të LZP-së, si dhe nenit 11.4 të Rregullës Zgjedhore 9/2009.

2. QV 0401X/19D –Lista Përfundimtare e Votuesve përmban 14 nënshkrime që tregojnë dëshmi rreth mashtrimit.

Lista Përfundimtare e Votimit,

faqja 1/ 3 nënshkrime mashtruese;
faqja 3/ 1 nënshkrim mashtrues;
faqja 8/ 1 nënshkrim mashtrues;
faqja 9/ 1 nënshkrim mashtrues;
faqja 10/ 1 nënshkrim mashtrues;
faqja 12/ 1 nënshkrim mashtrues;
faqja 13/2 nënshkrime mashtruese;
faqja 16/ 4 nënshkrime mashtruese.

Këto parregullsi të nënshkrimeve paraqesin shkelje të nenit 91.2 të LZP-së, si dhe nenit 11.4 të Rregullës Zgjedhore 9/2009.

3. QV 0402D/02R – Në këtë qendër votimi kryesuesi i vend votimit nuk e ka nënshkruar FPR- në Këshillin e Vendvotimit. Kjo paraqet shkelje të neni 15.4.e të Rregullës Zgjedhore 9/2009.
4. QV 0402X/09D - Lista Përfundimtare e Votuesve përmban 16 nënshkrime që tregojnë dëshmi rreth mashtrimit.

Lista Përfundimtare e Votimit,

faqja 2/ 1 nënshkrim mashtrues;

faqja 3/ 1 nënshkrim mashtrues;
faqe 4/ 1 nënshkrim mashtrues;
faqe 5/ 2 nënshkrime mashtruese;
faqe 8/ 2 nënshkrime mashtruese;
faqe 10/ 1 nënshkrim mashtrues;
faqe 11/ 1 nënshkrim mashtrues;
faqe 12/ 3 nënshkrime mashtruese;
faqe 13/ 1 nënshkrim mashtrues;
faqe 14/ 1 nënshkrim mashtrues;
faqe 15/ 1 nënshkrim mashtrues;
faqe 16/ 1 nënshkrim mashtrues.

Këto nënshkrime paraqesin shkelje të nenit 91.2 të LZP-së, si dhe Neni 11.4 të Rregullës Zgjedhore 9/2009.

5. QV 0410D/04D –FPR përmban tre nënshkrime të parregullta të anëtarëve të Këshillit të Vendvotimit në FPR. Kjo paraqet shkelje të neni 15.4.e të Rregullës Zgjedhore 9/2009.
6. QV 0415D/01R – FPR përmban tre nënshkrime të parregullta të tre anëtarëve të Këshillit të Vendvotimit në FPR. Kjo paraqet shkelje të neni 15.4.e të Rregullës Zgjedhore 9/2009.
7. QV 0415D/02D – FPR përmban tre nënshkrime të parregullta të tre anëtarëve të Këshillit të Vendvotimit në FPR. Kjo paraqet shkelje të neni 15.4.e të Rregullës Zgjedhore 9/2009.
8. QV 0421D/02D – FPR përmban një nënshkrim të parregullt të një anëtari të Këshillit të Vendvotimit dhe një mungesë të nënshkrimit nga një anëtar i KVV-së. Kjo paraqet shkelje të neni 15.4.e të Rregullës Zgjedhore 9/2009.
9. QV 0428D/01D – FPR nuk është nënshkruar nga dy anëtarë të Këshillit të Vendvotimit. Kjo paraqet shkelje të neni 15.4.e të Rregullës Zgjedhore 9/2009.
10. QV 0422D/01D – FPR nuk është nënshkruar nga dy anëtarë të Këshillit të Vendvotimit, dhe katër nënshkrime të parregullta të anëtarëve të KVV-së. Kjo paraqet shkelje të neni 15.4.e të Rregullës Zgjedhore 9/2009.
11. QV 0441D/02D - FPR përmban gjatë nënshkrime të parregullta nga anëtarët e Këshillit të Vendvotimit, të nënshkruara nga dorëshkrim i njëjtë. Kjo paraqet shkelje të neni 15.4.e të Rregullës Zgjedhore 9/2009.

Në bazë të nenit 120.1 pika b. të LZP Nr. 03/L - 073 është paraparë mundësia që para certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve dhe në rrethana të jashtëzakonshme është lënë mundësia që KZAP-i mundë të anuloi rezultatet në një vendvotim, apo të udhëzoj KQZ të urdhëroj përsëritjen e votimit në një qendër votimi, ndërsa neni 106.2 i të njëjti Ligj ka paraparë mundësinë që para certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve KQZ-ja mundë të urdhëroj rinumërimin e votave në cilin do vendvotim, qendër të numërimit, përsëritjen e votimit në një qendër votimi apo në një Komunë.

Është vlerësim i panelit të KZAP-it se në rastin konkret zgjedhja me e drejtë për ti evituar parregullsitë e evidentuara më lartë është udhëzimi për KQZ-në që të bëjë

rivotimin në Komunën e Gjilanit, sepse anulimi në një numër të kufizuar të vendvotimeve nuk do të ishte përgjigje adekuate për shkak të parregullsive të mëdha të konstatuara, nuk do të shprehte vullnetin e qytetarëve të kësaj komune, sepse numri i vogël i votave ku nuk ka parregullsi do të dëmtonte vullnetin e zgjedhësve në këtë komunë, e në të njëjtën kohë do të ndikonte edhe në vetë legjitimitetin e zgjedhjeve.

Për shkak të rezultatit të ngushtë të zgjedhjeve në mes të kandidatëve për kryetar të komunës së Gjilanit, KZAP-i vlerëson se anulimi i pjesërishëm i rezultatit të zgjedhjeve në ndonjë vendvotim do të bënte fitues njërin prej kandidatëve që nuk do të ishte e drejtë, duke pasur parasysh parregullsitë e konstatuara ashtu që është vlerësim i KZAP-it se e vetmja mundësi për ti evituar parregullsitë e theksuara është udhëzimi i KQZ-së që të urdhëroj përsëritjen e votimit në Komunën e Gjilanit, sepse e drejta për të votuar dhe për tu zgjedhur është e drejtë elementare e të drejtave të njeriut, e lidhur ngushtë me demokracinë dhe mbrojtja e votës së lirë është detyrë e çdo subjekti që të respekton vullnetin e qytetarit.

Me qëllim që zgjedhjet të jenë fer dhe demokratike dhe të evitohen parregullsitë eventuale, poqëse KQZ-ja, pranon udhëzimin e KZAP-it, atëherë rekomandohet që të ndërmerr këto masa:

- Të bëhet ndërrimi i Komisionerëve të Qendrave të Votimit;
- Të shtohet prezenca e Policisë së Kosovës në të gjitha Qendrat e Votimit dhe ;
- KQZ të shtoj mbikëqyrjen e gjatë procesit të votimit.

Mbi këtë bazë e në përputhje me nenet: 115.1, 117.2, 117.3, dhe 120.1 b. të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP (Ligji nr – 03/L - 073) dhe Ligji për Zgjedhjet Lokale (Ligji nr – 03/L - 072), u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa

A nr. 63/2010 me datë 04.02.2010



Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala